
Analizë e INDEP për Raportin Konsultativ të ZRRE-së mbi Mekanizmin e Mbështetjes për Caqet e BRE-ve (20 MW Solare Fotovoltaike)

ANALIZË E POLITIKAVE

05/2019



Analizë e INDEP për Raportin Konsultativ të ZRRE-së mbi Mekanizmin e Mbështetjes për Caqet e BRE-ve (20 MW Solare Fotovoltaike)

Autor: **Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)**

Programi: **Zhvillim i qëndrueshëm**

Publikimi: **Maj, 2019**

Foto e ballinës: **Pexels**



Zhvillimi i Qëndrueshëm
Sustainable Development

Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Mbështetur nga:



**Rockefeller
Brothers
Fund**

Ky punim është publikuar me mbështetjen e Fondacionit të Vëllezërve Rockefeller. Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, jo domosdoshmërisht reflektojnë ato të donatorëve të INDEP, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve apo Bordit.

Hyrje

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) ka analizuar Raportin Konsultativ të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) mbi Mekanizmin e Mbështetjes për Caqet e BRE-ve (20 MW Solare Fotovoltaike). Kjo analizë është në kuadër të programit të INDEP për Zhvillim të Qëndrueshëm. Analiza fokusohet në bazën ligjore dhe parimet për përcaktimin e llogaritjes së tariffës nxitëse si dhe përlogaritjen e saj.

Përcaktimi i mekanizmit të mbështetjes për caqet e BRE-ve është mjaft i rëndësishëm pasi ndikon edhe në koston që qytetarët e paguajnë si dhe në rritjen e pjesëmarrjes së BRE-ve në miaksin energjetik të Kosovës. Për këtë, vlerësimi i nivelit të tarifës nxitëse është mjaft i rëndësishëm. Në përcaktimin e tarifave nxitëse duhet të përcaktojmë fillimisht ligjshmërinë e procesit e pastaj materien e tij.

INDEP ka analizuar fillimisht bazën ligjore për hartimin e Udhëzimit Administrativ 05/2017 dhe rritjen e caqeve, të cilin Udhëzim e zbaton ky dokument i ZRRE-së. Kjo sepse dokumenti i ZRRE-së është drejtëpërdrejtë pasojë juridike e Udhëzimit Nr. 05/2017. Më pastaj është analizuar materia e dokumentit ku me theks të veçantë kemi analizuar elementet që kanë ndikuar në përcaktimin e vlerës që është propozuar dhe në fund, janë dhënë përfundime dhe rekomandime.

Konflikti ligjor

Ky dokument përcjellë një Udhëzim Administrativ të Ministrit të Zhvillimit Ekonomik në vitin 2017, z. Blerand Stavileci për Caqet e Energjisë nga Burimet e Ripërtrishme. Ky dokument i publikuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji, përcakton nivelin e propozuar të tarifës nxitëse për 20 MW kapacitet të energjisë solare fotovoltaike. Ky kapacitet është shtuar me vendim të Ministrisë në vitin 2017.¹ Ky vendim ishte i papritshëm, i shpejtuar dhe i pa konsultuar.

Dokumenti në konsultim publik përcakton tarifën nxitëse për këtë pjesë prej 20 MW të përcaktuar sipas Udhëzimit 05/2017. Megjithatë, Udhëzimi 05/2017 ka qenë i paligjshëm. Kjo sepse Ligji Nr. 05/L-081 për Energjinë përcakton qartësisht se caku për t'u mbuluar deri në vitin 2020 do të jetë 25%.

Qeveria i cakton caqet vjetore dhe afatgjata të energjisë së ripërtërishme për konsum të energjisë elektrike, të energjisë termike të prodhuar nga burime të ripërtërishme të energjisë dhe nga bashkëprodhimi, si dhe të energjisë nga burime të ripërtërishme që shfrytëzohet në transport. Qeveria do ta miratojë planin shtetëror të veprimit për energji të ripërtërishme për arritjen e cakut që 25% e konsumit të gjithmbarshëm bruto të energjisë në vitin 2020 të mbulohet nga energjia e ripërtërishme. Plani shtetëror i veprimit për energji të ripërtërishme, pas miratimit do t'i dorëzohet Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.²

¹ Ministria e Zhvillimit Ekonomik, (2017), Udhëzim Administrativ Nr. 05/2017, mbi Caqet e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme, Prishtinë: GZRKS.

² Republika e Kosovës, (2016), Ligji Nr. 05/L-081 për Energjinë, Neni 15, paragrafi 1, marrë nga <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12689> Prishtinë: GZRKS.

Pra, Udhëzimi Administrativ i vitit 2017, me ndryshimin e caqeve të cilat kanë pasur kosto për qytetarët, ka shkelur ligjin pasi nuk mundet që një akt nënligjor ta mbizotëroj ligjin. Për këtë, Zyra e Rregullatorit për Energji nuk do të duhej fare ta merrte parasysh dhe ta zbatonte një udhëzim administrativ antiligjor. Ky vendim i Ministrisë gjithashtu ishte arbitrare dhe i pa konsultuar. Shkelte nenin 6, pikën 9 të Ligjit Nr. 05/L-081 që parashihte se: “të gjitha dokumentet dhe udhëzimet që përgatiten nga Ministria do t’i nënshtrohen kërkesave të njëjta për konsultime publike dhe miratohen nga Ministria”³ Nuk kishte pasur fare konsultim publik, nuk ishte informuar e as konsultuar ZRRE dhe si rrjedhojë, një vendim me kosto për qytetarët, ishte marrë pa u konsultuar me ta. Pra, ky udhëzim është i paligjshëm, i marrë në mënyrë të paligjshme dhe të gjitha pasojat juridike pas tij janë të paligjshme.

Për këtë Udhëzim, edhe vet ZRRE shprehet se “ka krijuar paqartësi dhe pasiguri në politikën shtetërore të sektorit të energjisë.”⁴ Me të drejtë, ZRRE konstaton që ky vendim kishte në thelb dy probleme themelore: paqartësinë dhe pasigurinë që shkaktonte. Paqartësia ka të bëjë me faktin që Ligji Nr. 05/L-081 përcakton qartësisht cakun prej 25% ndërsa një akt nënligjor, në këtë rast Udhëzimi 05/2017 obligonte skemë mbështetëse me feed-in tarifë për një kapacitet shtesë që tejkalonte cakun e përcaktuar në ligj. Pasiguria që ky Udhëzim shkakton ka të bëjë me faktin që po merrej pa konsultim me askë, dhe kështu, përjoi mesazhin tek akterët në tregun e energjisë dhe për qytetarët se vendimet merren sipas dëshirës dhe tekeve të ministrave e jo sipas një procesi ligjor e demokratik.

Kjo paqartësi dhe pasiguri që shkaktoi ky ligj, nuk duhet legjitimuar me miratim të kësaj skeme. ZRRE, rrjedhimisht duhet të rezervohet nga zbatimi i këtij Udhëzimi, deri të bëhet plotësim-ndryshimi i Ligjit Nr. 05/L-081 për Energjinë ose të shfuqizohet Udhëzimi.

FIT i përlllogaritur

Edhe po të ishte Udhëzimi Administrativ në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-081 për Energjinë dhe i konsultuar me palët e i dakorduar, përlllogaritja e nivelit të tarifës nxitëse është shumë e lartë. ZRRE për përcaktimin e tarifës ka marrë për bazë këta faktorë:

- Investimet për gjeneratorë;
- Shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes (O&M), duke përfshirë edhe kostot e jobalanceve;
- Kosto e financimit (mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit);
- Kostot tjera që kanë të bëjnë me projektin.⁵

ZRRE përcakton se kostoja e shpenzimeve operative të mirëmbajtjes: “zakonisht sillen rreth 2%-3% në vit në raport me koston e investimit.”⁶ Paramentrat dhe studimet ku është bazuar një vlerësim i tillë nuk janë cituar. Megjithatë, tashmë dihet se kostot operative nuk janë më tepër se 1

³ Republika e Kosovës, (2016), Ligji Nr. 05/L-081 për Energjinë, Neni 6, paragrafi 9, marrë nga <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12689> Prishtinë: GZRKS.


⁴ Zyra e Rregullatorit për Energji, (2019), Draft Raport Konsultativ mbi Mekanizmin e Mbështetjes për Caqet e BRE-ve (20 MW Solare Fotovoltaike), faqe 3, Prishtinë: ZRRE.

⁵ Ibid.

⁶ Ibid, faqe 8.

deri në 1.5% në vit në raport me investimin.⁷ Gjithashtu kostoja e mirëmbajtjes së paneleve solare po bie dita ditës.⁸ Mirëmbajtja konsiderohet vetëm një fraksion i investimit dhe atë prej 1%.⁹ Këta parametra nuk mund të jenë ndryshe dhe konsiderojmë që vlera 2 deri 3% e investimit në vit të jetë për mirëmbajtje është shumë e lartë.

Kostoja e energjisë solare po bie dita ditës. Vetëm nga viti 2010 kostoja e moduleve fotovoltaike ka rënë për 82%.¹⁰



Source: GlobalData, 2017; pvXchange, 2017; Photon Consulting, 2017.

Figure 1. Trendet rënëse të kostonë së investimit në energji solare

Në raportin e ZRRE-së, kostoja mesatare e ponderuar e kapitalit është vlerësuar të jetë 8.3%. Në konsiderojmë që një vlerë e tillë është shumë e lartë dhe duhet rishikuar. Vlerësimi është i lartë edhe për shkak të projekteve me kapacitet kryesisht të vogël edhe për shkak se vlera e kostonë së niveluar të energjisë për WACC 8.3% është dukshëm më e vogël.

⁷ PFS, (2019), What Are The Operational Costs Of A Solar Panel System?

<https://www.powerfromsunlight.com/operational-costs-solar-panel-system/>

⁸ Power Technology, (2016), Solar array maintenance: why are costs falling?, <https://www.power-technology.com/features/featuresolar-array-maintenance-why-are-costs-falling-4872202/>

⁹ Wilfried G.J.H.M. van Sark, Tony Schoen, (2017), Photovoltaic System and Components Price Development in the Netherlands, 33rd European Photovoltaic Solar Energy Conference and Exhibition.

¹⁰ Ralon, Pablo, (2018), Global renewable energy cost tr, <http://www.recem.org/wp-content/uploads/2018/04/Pablo-Ralon-IRENA.pdf>

Figure 4.13: Cost-competitive solar PV potential in Kosovo in 2016




Figure 2. LCOE ne raport me skenarë të ndryshëm të WACC në Kosovë. Burimi: IRENA

Në skenarin me 8% WACC, sipas grafikës së mësipërme LCOE nuk vlerësohet në vlerën 90 por dukshëm më pak. Gjithashtu, Vlera e WACC për energji solare fotovoltaike në Shqipëri është 7.5%.¹¹ Vlerësimi i rrezikut më i lartë në Kosovë për pothuaj 1% është i paarsyeshëm.

Përfundime dhe Rekomandime

- Zyra e Rregullatorit për Energji të mos miratoj feed-in tarifë për 20 MW solare fotovoltaike pasi Udhëzimi Administrativ 05/2017 ka qenë joligjor. Rrjedhimisht, ZRRE nuk mund të marrë vendim për feed-in tarifë për caqe shtesë të cilat janë në kundërshtim me cakun e përcaktuar në Ligjin Nr. 05/L-081 për Energjinë.
- Të ulët kostoja e përlogaritur e mirëmbajtjes nga 2-3% në 1% në vit. Kjo kosto paraqet koston e vërtetë të mirëmbajtjes për investimet në energjinë solare dhe si e tillë duhet të reflektohet në dokument.
- Të ulët kostoja mesatare e ponderuar e kapitalit në së paku 7.5%. Që nga viti 2010 deri në vitin 2018 niveli i kredihënjes për biznese në Kosovë është dyfishuar dhe kostoja e tyre është ulur. Kjo medoemos duhet reflektuar edhe në kalkulimet e ZRRE-së. Ky vlerësim nuk është arsyetuar dhe kjo ka rritur edhe vlerën e Feed-in tarifës së llogaritur.
- Çmimi i lartë i feed-in tarifës vërtetohet edhe nga kalkulimet e IRENA mbi WACC dhe nivelit të LCOE për energjinë solare fotovoltaike. Edhe nëse pranojmë një WACC prej 8.4%, LCOE nuk duhet të jetë më shumë se 80 euro. Pa jka se niveli i WACC i përlogaritur është shumë i lartë.

¹¹ RES LEGAL, (2019), Legal resources on renewable energy, Albania, i qasshëm në <http://www.res-legal.eu/search-by-country/albania/single/s/res-e/t/promotion/aid/feed-in-tariff-11/lastp/490/> (qasur në maj, 2019).

- ZRRE duhet të marrë në konsideratë këto komente dhe po qe e nevojshme, të rrisë kohën e konsultimit dhe të organizoj edhe tryeza shtesë ose diskutime fillimisht në lidhje me ligjshmërinë e rritjes së caqeve ligjore përmes akteve nënligjore e pastaj edhe për nivelin e feed-in tarifës.